

VENDIM
Nr.545, datë 1.5.2008

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

a) Në fund të shkronjës “a” të pikës 1 shtohet emërtesa “Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit”.

b) Pas paragrafit të dytë, të pikës 12 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:
“Për nëpunësit e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve të jepet shtesë për kushte pune, si më poshtë vijon:

i) për pozicionin “Titullar i institucionit”, 13 000 (trembëdhjetë mijë) lekë mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse;

ii) për pozicionet “Drejtor drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në drejtoritë dhe sektorët teknikë të institucionit, 10 000 (dhjetë mijë) lekë mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse.”.

2. Pagat për pozicionet mbështetëse në Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit të jenë sipas lidhjeve II/M dhe II-5, që i bashkëlidhen vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

3. Efektet financiare për vitin 2008, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për secilin institucion, për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha